Numër: 01-466
Datë: 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e II-të e mbajtur me datë 29.05.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Riakreditohet dhe rivalidohet Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë (Sh.M.L.M) "Akademia Profesionale D.C. Kalabri, Veternik, objekti Veranda, D4, hyrja B, Prishtinë, Kosovë për periudhën pese (5) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2026 deri 30.08.2031, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1 **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional deri me njëzetetetë (24) nxënës në një klase, dhe ne total mund të ofroi deri ne dy (2) klasa brenda vitit shkollor.

1. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Sh.M.L.M "Akademia Profesionale D.C, për rivalidim & riakreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 02.04.2026 për kualifikimin: Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, Niveli III dhe IV sipas KKK ndërsa vizita është realizuar me datën 10.04.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 03.05.2026, Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 29.05.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Për një vit kalendarik, lejohen (2) dy klase brenda viti me nga 24 nxënës, që në total bëjnë 48 nxënës (2x24=48) nxënës për një vit. Kjo shifër reflekton kapacitetin aktual të institucionit për të pranuar dhe përkrahur nxënësit në kuadër të këtij kualifikimi.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Sh.M.L.M "Akademia Profesionale D.C"
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK